

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

INDEKSI I TRANSPARENCËS PROAKTIVE TË NJËSIVE TË VËTËQEVERISJES VENDORE

Dhjetor 2023



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA PROAKTIVE E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE (NJVV)

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	2
METODOLOGJIA	5
INDEKSI I TRANSPARENCËS PROAKTIVE PËR NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE	10
BASHKITË.....	10
KËSHILLAT E QARQEVE.....	15
GJETJET PËRFUNDIMTARE “INDEKSI I TRANSPARENCËS PROAKTIVE PËR NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE”	17

Hyrje

E drejta për informim është një e drejtë që garantohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Aksesin në informacionin publik nuk përbën vetëm një nga të drejtat themelore të njeriut, por është parakusht për një qeverisje të hapur që garanton transparencë dhe llogaridhënie. Transparenca është element kyç në një shoqëri demokratike dhe shërben për t’i dhënë medias, shoqërisë civile dhe qytetarëve mjete për të analizuar se si menaxhohet pushteti dhe burimet e shtetit.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr.78, datë 21.09.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, janë forcuar edhe më tej rregullat, mekanizmat dhe procedurat për njohjen me informacion/dokumentacion me karakter publik nga qytetarët.

Ndër ndryshimet kryesore në këtë ligj është përfshirja dhe zgjerimi i kompetencave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në fushën e të drejtës për informim, shtrirja e përgjegjësisë për mospërmbyshjen e detyrimeve të legjislacionit për të drejtën e informimit tek të gjithë punonjësit e autoritetit publik, forcimi i rolit të koordinatorit, rishikimi i kufijve minimal të sanksioneve administrative për shkeljet e detyrimeve të këtij ligji, si dhe publikimi i informacionit të përditësuar në Programin e Transparencës në çdo rast që pëson ndryshime, duke shënuar edhe datën e përditësimit të fundit.

Ligji për të drejtën e informimit (LDI) parashikon se autoritetet publike duhet të publikojnë në mënyrë proaktive informacion mbi veprimtarinë e tyre nëpërmjet instrumentit të programit të transparencës në faqen e tyre zyrtare. Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale miraton dhe shpërndan modele të programit të transparencës në përputhje me parashikimet ligjore të LDI-së.

Transparenca proaktive i ofron qytetarëve mundësinë për të pasur akses në informacion me karakter publik pa pasur nevojë për të bërë një kërkesë tradicionale pranë autoritetit publik. Bërja publike e informacionit në mënyrë proaktive sjell përfitim të ndërsjellë si për autoritetet publike ashtu edhe për qytetarët, pasi ju jep atyre mundësinë për akses më të shpejtë në informacion dhe shërbime, por nga tjetër i bën autoritetet publike më eficientë në punën e tyre. Transparenca proaktive e njësive të vetëqeverisjes vendore është thelbësore për një qeverisje të përgjegjshme, për të forcuar besimin dhe nxitur pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me Urdhrin nr. 211, datë 10.09.2018, ka miratuar “Programin Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”, i cili është i detyrueshëm për t’u zbatuar nga 61 bashkitë e vendit që prej 1 janarit

2019. Programi model është hartuar në përputhje me kërkesat e nenit 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, dhe i përshtatur në kontekstin e vetëqeverisjes vendore, në përputhje dhe në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si dhe të ligjit nr. 8548, datë 11.11.1999, “Për ratifikimin e “Kartës evropiane të autonomisë vendore”.



Një nga fazat e rëndësishme në sigurimin e transparencës në nivel vendor është edhe monitorimi i zbatimit të Programit Model të Transparencës. Monitorimi mundëson vlerësimin e nivelit të transparencës të çdo njësie të vetëqeverisjes vendore. Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është autoriteti përgjegjës për monitorimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e dispozitave të ligjit për të drejtën e informimit dhe në rastet kur konstatohet mosrespektimi i tyre, bën vlerësimin e kundërvajtjeve dhe vendos sanksionet administrative përkatëse.

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka monitoruar gjatë periudhës nëntor - dhjetor 2023, faqet zyrtare të 61 njësive të vetëqeverisjes vendore për respektimin e detyrimit ligjor për vënien në zbatim të programit të transparencës, në të cilin përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publike pa kërkesë, sipas Urdhrit nr. 211, datë 10.09.2018, për miratimin e “Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”.

Nga procesi i monitorimit ka rezultuar se një pjesë e njësive të vetëqeverisjes vendore kanë pasur mangësi në publikimin dhe përditësimin e informacionit të detyrueshëm për tu bërë publik në rubrikat e këtij programi. Gjithashtu, është konstatuar se në disa faqe zyrtare të tyre ka pasur probleme të përkohshme teknike të aksesit.

Transparenca proaktive është një proces i vazhdueshëm i cili kërkon angazhimin e autoriteteve publike për të publikuar, përditësuar dhe pasuruar me informacion të gjitha rubrikat e programit të transparencës. Për këtë arsye, Zyra e Komisionerit monitoron transparencën e njësive të vetëqeverisjes vendore çdo vit, duke bërë të mundur kryerjen e analizave krahasimore në të ardhmen.

Zyra e Komisionerit përtej angazhimit të saj institucional në monitorimin e zbatimit të detyrimit ligjor për miratimin, publikimin dhe përditësimin e Programit të Transparencës, sjell për vitin e katërt radhazi “Indeksin e Transparencës së Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”. Ky indeks ndjek një metodologji të caktuar e cila shërben kryesisht për të sjellë një analizë krahasuese të nivelit të transparencës proaktive të njësive të vetëqeverisjes vendore, duke krahasuar trendin e transparencës së tyre ndër vite.

Metodologjia

Sistemi i matjes i përdorur në këtë monitorim i referohet 10 treguesve kryesorë, të cilët bëjnë vlerësimin objektiv të nivelit funksional të transparencës proaktive të njësive të vetëqeverisjes vendore. Numri total i pikëve të vlerësimit të treguesve është 10 (dhjetë). Bazuar në pikëzimin e çdo treguesi llogaritet shuma totale e vlerësimit për secilën njësi të vetëqeverisjes vendore.

Instrumenti kryesor për matjen e transparencës proaktive është publikimi i Programit Model të Transparencës dhe Programit të Transparencës së Rishikuar në faqen zyrtare të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Sistemi i matjes i përdorur në këtë metodologji është i thjeshtë dhe lejon një vlerësim të shpejtë të treguesve bazuar në gjendjen reale të tyre në momentin e kërkimit në faqen zyrtare të internetit.

Ky sistem matje i transparencës proaktive i referohet dhe është i ngjashëm me sistemin e matjes së transparencës së njësive të vetëqeverisjes vendore për vitin 2022, i cili është i publikuar në faqen zyrtare të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në lidhjen: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2022/03/Indeksi_-i-transparences_-bashkite_monitorim_bashkite_dhjetor_2022_me-kopertine-perfundimtar.pdf. Indeksi i Transparencës për vitin 2023 ka një përmirësim në krahasim me atë të një viti më parë. Ky përmirësim është një përmirësim sasior i të dhënave, të përfshira në këtë indeks. Në këtë indeks janë marrë në analizë 10 kategori informacioni përkundrejt 9 kategorive të mëparshme në vitin 2022.

Ndërkohë sistemi i matjes së treguesve vazhdon të jetë i njëjti si ai i vitit 2022. Matja e treguesve është kryer me 3 nivele: 0 pikë në rast se informacioni nuk është publikuar; 0,5 pikë kur informacioni është publikuar pjesërisht dhe 1 pikë kur informacioni është i publikuar plotësisht.

Më poshtë gjenden të renditura të dhjetë treguesit e analizuar.

Treguesi i parë:

Publikimi i Programit Model të Transparencës për Autoritetet Publike sipas urdhrit të Komisionerit nr. 211, datë 10.09.2018, “Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”.

Vlerësimi: 0 - informacioni nuk është publikuar

0,5 - informacioni është publikuar pjesërisht

1 - informacioni është i publikuar

Treguesi i dytë:

Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak.

Vlerësimi: 0 - informacioni nuk është publikuar

0,5 - informacioni është publikuar pjesërisht

1 - informacioni është i publikuar

Treguesi i tretë:

Publikimi i CV-së së titullarit të autoritetit publik.

Vlerësimi: 0 - informacioni nuk është publikuar

0,5 - informacioni është publikuar pjesërisht

1 - informacioni është i publikuar

Treguesi i katërt:

Publikimi i strukturës së bashkisë.

Vlerësimi: 0 - informacioni nuk është publikuar

0,5 - informacioni është publikuar pjesërisht

1 - informacioni është i publikuar

Treguesi i pestë:

Publikimi i raporteve të auditimit dhe monitorimit (p.sh. Raporte KLSH ose Raporte Audite te Brendshme).

Vlerësimi: 0 - informacioni nuk është publikuar

0,5 - informacioni është publikuar pjesërisht

1 - informacioni është i publikuar

Treguesi i gjashtë:

Publikimi i të dhënave PBA 2023-2025 dhe regjistrin të parashikimeve të prokurimit publik.

Vlerësimi: 0 - informacioni nuk është publikuar

0,5 - informacioni është publikuar pjesërisht

1 - informacioni është i publikuar

Treguesi i shtatë¹:

Publikimi i të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.

Vlerësimi: 0 - informacioni nuk është publikuar

0,5 - informacioni është publikuar pjesërisht

1 - informacioni është i publikuar

Treguesi i tetë²:

Publikimi i Regjistri të Kërkesave dhe Përgjigjeve i përditësuar gjatë vitit 2023, sipas urdhrit nr. 188, dt. 18.12.2020, “Për miratimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve të rishikuar”.

Vlerësimi: 0 - informacioni nuk është publikuar

0,5 - informacioni është publikuar pjesërisht (nuk është vendosur përgjigja e kërkesës për informacion)

1 - informacioni është i publikuar

Treguesi i nëntë:

Publikimi i legjislacionit.

Vlerësimi: 0-informacioni nuk është publikuar

¹ Janë shënuar me (*) të dhënat e koordinatorëve për të drejtën e informimit dhe regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit, të cilat i janë bërë me dije Zyrës së Komisionerit dhe janë përditësuar në portalin pyetshtetin.al. Kjo është kryer vetëm në rastet kur gjatë monitorimit nuk ka qenë e mundur identifikimi i të dhënave të koordinatorit për shkaqe si problem i aksesit apo mosfunksionimi i përkohshëm i faqes zyrtare të autoritetit publik të monitoruar.

² Idem

0,5-informacioni është publikuar pjesërisht

1-informacioni është i publikuar

Treguesi i dhjetë:


Publikimi i informacionit mbi “Të dhënat e Koordinatorit për Njoftimin dhe Konsultimin publik”.

Vlerësimi: 0 - informacioni nuk është publikuar

0,5 - informacioni është publikuar pjesërisht

1 - informacioni është i publikuar

Pas monitorimit për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore për 10 treguesit e mësipërm, numri i pikëve do të mblihet për secilën prej tyre dhe do të renditen në indeks duke filluar nga institucioni që ka grumbulluar më shumë pikë dhe duke zbritur deri tek ajo me numrin më të ulët të pikëve. Renditja e autoriteteve publike brenda të njëjtit grupim me të njëjtin numër pikësh është e rastësishme. Për të evidentuar më mirë, qasjen ndaj transparencës proaktive të njësisive të vetëqeverisjes vendore, Zyra e Komisionerit për të katërtin vit radhazi paraqet sistemin e matjes të transparencës proaktive nëpërmjet një sistemi semafor.



Njësitë e vetëqeverisjes vendore që i kanë të gjithë treguesit negativ dhe për këtë arsye kanë grumbulluar 0 - 2 pikë, kanë një transparencë proaktive të pamjaftueshme dhe në semafor shënohen me dritë të kuqe.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore që kanë grumbulluar 2.5 – 4.5 pikë, kanë një transparencë proaktive të ulët dhe në semafor janë shënuar me dritë të verdhë.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore që kanë grumbulluar 5 – 8.5 pikë, kanë një transparencë proaktive mesatare dhe në semafor janë shënuar me dritë të bardhë.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat i kanë të gjithë treguesit pozitiv dhe kanë grumbulluar 9 - 10 pikë, kanë një transparencë proaktive të lartë dhe në semafor janë shënuar me dritë të gjelbër.

Indeksi i Transparencës Proaktive për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoroi në periudhën nëntor – dhjetor të vitit 2023 faqet zyrtare të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Në tabelën e mëposhtme janë evidentuar 10 treguesit kryesorë të monitorimit të cilat janë: *publikimi i programit të transparencës sipas urdhrit nr.211, datë 10.09.2018, “Për Miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”*; *publikimi i vendimeve të Këshillit Bashkiak*, *publikimi i CV-së së titullarit*; *publikimi i strukturës së bashkisë*; *publikimi i raporteve të auditimit dhe monitorimit (p.sh. Raporte KLSH ose Raporte Audite te Brendshme)*; *publikimi i të dhënave PBA 2023-2025 dhe publikimi i regjistrit të parashikimeve të prokurimit publik*; *publikimi i të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit*; *publikimi i regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve i përditësuar për 2023*, *publikimi i legjislacionit*; *publikimi i informacionit mbi “Të dhënat e Koordinatorit për Njoftimin dhe Konsultimin publik” për njësitë e vetëqeverisjes vendore/bashkitë për 2023*.

BASHKITË

Autoriteti Publik	Program Transparence	Vendime KB	CV titullari	Struktura	Raportet e auditimit	PBA 2023 - 2025 dhe regjistri i parashikimeve të prokurimit publik	Koordinatori për të drejtën e informimit	Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve	Legjislacioni	Koordinatori për konsultimin me publikun	Total
Bashkia e Mirditës	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	10
Bashkia e Patos	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	10
Bashkia e Shkodrës	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	10

Bashkia Dropull	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	10
Bashkia Tiranë	1	1	1	1	1	0.5	1	1	1	1	1	9.5
Bashkia Korçë	1	1	1	1	1	1	1	1	0.5	1	1	9.5
Bashkia Belsh	1	1	1	1	1	1	1	1	0.5	1	1	9.5
Bashkia Maliq	1	1	1	1	1	1	1	1	0.5	1	1	9.5
Bashkia Malësi e Madhe	1	1	1	1	1	0.5	1	1	1	1	1	9.5
Bashkia Skrapar	1	1	1	1	1	0.5	1	1	1	1	1	9.5
Bashkia Lezhë	1	1	1	1	1	0.5	1	1	1	1	1	9.5
Bashkia Bulqizë	1	1	0.5	1	0.5	1	1	1	1	1	1	9
Bashkia Prrenjas	1	1	1	1	1	0.5	1	0.5	1	1	1	9
Bashkia Klos	1	1	1	1	1	0.5	1	1	0.5	1	1	9
Bashkia Mat	1	1	1	1	1	0.5	1	0.5	1	1	1	9
Bashkia Berat	1	1	1	1	1	0.5	1	1	0.5	1	1	9
Bashkia Kukës	1	1	1	1	0.5	0.5	1	1	1	1	1	9
Bashkia Selenice	1	1	1	1	1	0	1	1	1	1	1	9

Bashkia Roskovec	1	1	1	1	0	1	1	0.5*	1	1	8.5
Bashkia Devoll	1	1	1	1	1	1	1	0.5	1	0	8.5
Bashkia Kolonjë	1	1	1	1	1	0.5	1	1	1	0	8.5
Bashkia Himarë	1	1	1	1	0	0.5	1	1	1	1	8.5
Bashkia Elbasan	1	1	1	1	0.5	0.5	1	0.5**	1	1	8.5
Bashkia Vlorë	1	1	1	1	0	0.5	1	1	0.5	1	8
Bashkia Vau i Dejës	1	1	1	1	0	0.5	1	1	0.5	1	8
Bashkia Fiq	1	1	0.5	1	1	0	1	0.5	1	1	8
Bashkia Peqin	1	1	0	1	1	0	1	1	1	1	8
Bashkia Libohovë	1	1	0	1	1	0	1	1	1	1	8
Bashkia Cërrik	1	1	1	1	1	0.5	1	0.5*	1	0	8
Bashkia Pogradec	1	1	1	1	0	0.5	1	0.5	1	1	7.5
Bashkia Poliçan	1	1	0	1	0	1	1	0.5	1	1	7.5
Bashkia Përmet	1	1	1	1	0	0.5	1	0.5	0.5	1	7.5
Bashkia Shijak	1	1	1	1	0	0.5	1	0.5	0.5	1	7.5
Bashkia Tropojë	1	1	1	1	0	0.5	1	1	1	0	7.5

Bashkia Lushnje	1	1	0	1	0.5	0.5	1	0.5	1	1	7.5
Bashkia Fier	1	1	0.5	1	0.5	0.5	1	1	0	1	7.5
Bashkia Dimal	1	1	1	1	0	0	1	0.5*	1	1	7.5
Bashkia Dibër	1	1	0	1	0.5	0	1	1	1	1	7.5
Bashkia Kamëz	1	0.5	1	1	0	0.5	1	1	1	0	7
Bashkia Memaliaj	1	1	0	1	0.5	0.5	1	0.5	1	0.5	7
Bashkia Krujë	1	1	1	1	0	0.5	1	0.5	1	0	7
Bashkia Kurbin	1	1	1	1	0	0	1	1**	0	1	7
Bashkia Delvinë	1	0	1	1	0	0.5	1	1	1	0	6.5
Bashkia Sarandë	1	1	0	1	1	0.5	1	1	0	0	6.5
Bashkia Vorë	1	1	0.5	1	0.5	0	1	0.5	0	1	6.5
Bashkia Pukë	1	1	1	1	0.5	0	1	0	1	0	6.5
Bashkia Këlcyrë	1	1	1	1	0	0	1	0.5	1	0	6.5
Bashkia Kuçovë	1	1	0	1	0	0	1	0.5	1	1	6.5
Bashkia Mallakastër	1	0	0.5	1	0.5	0	1	1	0	1	6
Bashkia Konispol	1	1	1	1	0	0	1	0	1	0	6

Bashkia Librazhd	1	1	1	1	0	0	1	1**	0	0	6
Bashkia Gjirokastrë	1	0.5	0.5	1	0	0.5	1	1	0	0	5.5
Bashkia Has	1	0	0.5	1	0.5	0	1	0.5	1	0	5.5
Bashkia Divjakë	1	0	0	0	0.5	0.5	1	0.5	1	1	5.5
Bashkia Fushë-Arrëz	1	0	0	1	0	0	1	1	1	0	5
Bashkia Tepelenë	1	0.5	0	0	0	0.5	1	0.5	1	0	4.5
Bashkia Gramsh	1	0	0	1	0	0.5	1	0.5	0	0	4
Bashkia Durrës	1	1	0	0	0	0	1	1	0	0	4
Bashkia Pustec	1	1	0	0	0	0	1	0.5	0	0	3.5
Bashkia Rrogozhinë	0	0.5	0	0	0	0	1	1**	0	0	2.5
Bashkia Kavajë	0	0	1	0	0	0	1*	0	0	0	2

KËSHILLAT E QARQEVE

Autoritete Publike	Programi i Transparençës ³	Struktura e autoritetit publik	Funksionet dhe detyrat	CV e titullarit	Legjislacion	Koordinatori	Raportet monitorimi/auditimi	Buxheti 2023	Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik	Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve 2023	Total
Këshilli i Qarkut Berat	1	1	1	1	1	1	0.5	0.5	1	1	9
Këshilli i Qarkut Elbasan	1	1	1	1	0.5	1	0	1	1	1*	8.5
Këshilli i Qarkut Shkodër	1	1	1	1	0.5	1	1	1	0	1	8.5
Këshilli i Qarkut Durrës	1	1	1	0	1	1	0	1	1	0.5	7.5
Këshilli i Qarkut Korçë	1	1	1	1	1	1	0	0	1	0.5	7.5
Këshilli i Qarkut Kukës	1	1	1	0	0.5	1	0	1	0.5	0.5	6.5
Këshilli i Qarkut Tiranë	1	1	0	1	0.5	1	0	0	1	1*	6.5
Këshilli i Qarkut Vlorë	1	1	1	1	0.5	1	0	0	0	0.5	6


³ Treguesit e këtyre institucioneve janë vlerësuar sipas atyre të Indeksit të Transparençës së autoriteteve qendrore dhe të varësisë, pasi këto institucione zbatojnë programin e transparençës sipas Urdhrit nr. 187, dt. 18/12/2020, "Për miratimin e Programit të Transparençës të rishikuar", i ndryshuar.

Këshilli i Qarkut Dibër	1	1	1	0	1	1	0	0	0	0.5	5.5
Këshilli i Qarkut Gjirokastrë	0	1	0	0	0	1*	0	0	0	1*	3
Këshilli i Qarkut Fier	0	0	0	0	0	1*	0	0	0	1*	2
Këshilli i Qarkut Lezhë	0	0	0	0	0	1*	0	0	0	1*	2

GJETJET PËRFUNDIMTARE “INDEKSI I TRANSPARENCËS PROAKTIVE PËR NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE”

Institucionet e njësisve të vetëqeverisjes vendore janë renditur në “Indeksin e Transparencës Proaktive” sipas rezultateve të monitorimit bazuar në metodologjinë e semaforit.

Në përfundim të monitorimit të transparencës proaktive vërejmë se 21 njësi të vetëqeverisjes vendore janë klasifikuar me transparencë proaktive të lartë dhe në semafor janë shënuar me dritë të gjelbër, ndërsa 43 institucione të njësisve të vetëqeverisjes vendore janë klasifikuar me transparencë proaktive mesatare dhe në semafor janë shënuar me dritë të bardhë; 6 njësi të vetëqeverisjes vendore janë renditur me transparencë proaktive të ulët dhe në semafor janë shënuar me dritë të verdhë; vetëm 3 njësi të vetëqeverisjes vendore janë klasifikuar me transparencë proaktive shumë të ulët dhe në semafor shënohen me dritë të kuqe. Në krahasim me gjetjet e vitit të kaluar, kemi konstatuar rritje të transparencës tek njësitë e vetëqeverisjes vendore me semafor të gjelbër nga 21 % në vitin e kaluar në 29 % për këtë vit çka shënon dhe përmirësimin më të dukshëm të bërë nga të gjithë vitet e kaluara, në transparencën proaktive të autoriteteve publike të njësisve të vetëqeverisjes vendore.



21 njësi të vetëqeverisjes vendore kanë “Transparencë proaktive të lartë” (semafor i gjelbër).

43 njësi të vetëqeverisjes vendore kanë “Transparencë proaktive mesatare” (semafor i bardhë).

6 njësi të vetëqeverisjes vendore kanë “Transparencë proaktive të ulët” (semafor i verdhë).

3 njësi të vetëqeverisjes vendore kanë “Transparencë proaktive shumë të ulët” (semafor i kuq).